## Titulli i lëndës: LETËRSI ZVICERANE

| Informatat themelore për lëndën | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Filologjisë: Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë gjermane |
| Titulli i lëndës: | Letërsi zvicerane |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | Me zgjedhje |
| Viti i studimeve: | Viti IV, semestri VII |
| Numri i orëve në javë: | 2+2 |
| Kreditë ECTS: | 3 ECTS |
| Koha / Vendi: | Klasa 32, sipas orarit |
| Mësimdhënësi: | Prof. dr. Naim Kryeziu |
| Të dhënat kontaktuese: | naim.kryeziu@uni-pr.edu naimkryeziu@bluewin.ch |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda e letërsisë zvicerane synon t'i njohë studentët me veçoritë më të rëndësishme të zhvillimit të kësaj letërsie. Siç dihet, letërsia zvicerane ndahet, sipas trevave gjuhësore, në letërsi gjermane, franceze, italiane dhe retoromane. Por letërsia e krijuar në trevën gjermanishtfolëse të Zvicrës është njësoj si edhe letëristë e krijuara në trevat e tjera gjermanishtfolëse, për shembull, letërsia austriake. Këto dy letërsi, pra, letërsia zvicerane dhe letërsia austriake, i takojnë secila një hapësire të veçantë gjeografike, por nuk janë letërsi të ndryshme, sepse që të dyja i përkasin hapësirës kulturore gjermane dhe bëjnë pjesë në letërsinë gjermane.<br>Gjatë zhvillimit të kësaj lënde studentët do të përvetësojnë karakteristikat më thelbësore të letërsisë zvicerane, ndihmesën që kanë dhënë autorët përkatës dhe veprat e tyre në letërsinë gjermane. Studentët do të njihen gjithashtu me shkrimtarët dhe me poetët e mëdhenj zviceranë, siç janë: Jermias Gothelfi, Gotfrid Keleri, Konrad Ferdinand Majeri, Jakob Kristof Herri, Johana Spyri, Peter Bihseli, Tomas Hyrlimani, Fridrih Dyrrenmati, Maks Frishi, Robert Valzeri dhe dy laureatët e çmimit Nobel për letërsinë, Karl Shpitleri dhe Herman Hesja. |

| | |
|---|---|
| Qëllimet e lëndës: | Lënda "Letërsi Zvicerane" synon që studenti:<br>• studimi i epokave të zhvillimit të historisë së letërsisë zvicerane<br>• njohja e karakteristikave më kryesore të letërsisë zvicerane<br>• njohja e veprave dhe autorëve të letërsisë zvicerane. |

| | |
|---|---|
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas mbarimit të kësaj lënde studenti duhet të jetë në gjendje të njohë<br>• letërsinë zvicerane në përgjithësi<br>• zhvillimet dhe karakteristikat e letërsisë zvicerane<br>• autorët zviceranë dhe veprat e tyre<br>• rëndësinë e letërsisë zvicerane<br>ndihmesën e letërsisë zvicerane në lëmin kulturor të Zvicrës. |

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | 15min | 4 | 1 |
| Testi, punimi i seminarit | 5 | 1 | 5 |
| Detyrë shtëpie | 1 | 15 | 15 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 4 | 2 | 8 |
| Përgatitja për provimin final | 15 | 1 | 15 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 2 | 1 | 2 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| Total | | | 76:25=<br>3.04<br>3 ECTS |

| | |
|---|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me shpjegime përkatëse. Gjatë shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Në fillim të ligjëratës zhvillohet gjithmonë debat për leksionin e mëparshëm. Në fund të ligjëratës bëhet një përsëritje e përbashkët e leksionit pasues. |

| | |
|---|---|
| Metodat e vlerësimit: | • Pjesëmarja aktive dhe detyrat 20 %<br>• Testi i parë 30 %<br>• Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) 50% |
| Literatura primare: | 1. *,,Schweizer Literaturgeschichte”*<br>Hrsg.: Peter Rusterholz und Andreas Solbach<br>Verlag: Metzler, 2007<br>ISBN-13: 97883476017369<br>2. Literaturwissenschaft: *,,Macht in der deutsch-schweizer Literatur”*<br>Deutsch herausgegeben von Martins de Oliveira, Reresa; Vilas-Boas, Gonçalo<br>Verlag: Frank & Timme, 2012<br>ISBN -13: 9783865964113<br>3. *,,Europäische Kulturbeiträge im deutsch-schweizerischen Schrifttum von 1850-2000 “*<br>Autoren: Joserf Rattner und Gerhard Danzer<br>Verlag: Königshausen & Neumann GmbH, 2003 |
| Literatura shtesë: | 1. Knaurs Lexikon der Weltliteratur, OSBN 3-426-26625-3, Krywalski, Diether (Hrsg), München: Droemer Knaur 1992 |

| **Hartimi i planit mësimor** | |
|---|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java 1: | Fillesat e letërsisë zviceranë deri në 1700: Periudhat – historia - letërsia. |
| Java 2: | Topografia letrare. |
| Java 3: | Tipet e autorëve. |
| Java 4: | *Fillesat letrare: Lirika, epika dhe dramatika.* |
| Java 5: | Letërsia shkencore – gjermanisht në mësimet universitare. |
| Java 6: | Shekulli i tetëmbdhjetë (1700-1830): Kufizimet kohore dhe gjeografike; Iluminizimi dhe realizmi; Kosmopolitizmi; Zvicëra në Evropë; Kultura në Zvicër në pjesën gjermanishtfolësese. |
| Java 7: | Kultura shoqërore. |
| Java 8: | Gotfrid Keler (Gottfriede Keller) – Letërsia që nga koha e themelimit të shtetit federal |
| Java 9: | Veprat e Gotfrid Kelerit: “*Veshja të bën njëri*” dhe “*Romeo dhe Zhuljeta në fshat*”. |
| Java 10: | Herman Hese (Hermann Hesse): Periudha prej 1914 deri në Luftën e Dytë Botrore. |
| Java 11: | Verprat e Herman Heses: “*Narcisi dhe Gojarti*” dhe “*Loja e rruazave prej qelqi*”. |

| | |
|---|---|
| Java 12: | Letërsia pas 1945 – Maks Fish (Max Frisch) dhe Fridrih Dyrrenmat (Friedrich Dürrenmatt). |
| Java 13: | Veprat e Maks Frishit: “*Homo Faber*” dhe “*Don Juan” .* |
| Java 14: | Fridrih Dyrrenmat (Friedrich Dürrenmat): Shpirti i letërsisë zvicërane. |
| Java 15: | Verprat e Fridrih Dyrrenmatit: “*Dyshimi*” dhe “*Vizita e zonjës plakë*”. |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët duhet të vijnë me kohë në auditor, sepse ardhja me vonesë sjell ndërprerjen e mësimit dhe pengon, çrregullon e shpërqendron vëmendjen e studentëve. Gjatë orës së mësimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike, sepse shkaktojnë zhurmë ose pengesa të tjera.

*Hartoi: Prof. dr. Naim Kryeziu/04.04.2025/NKr*